

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 108A të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Për: KOMUNA SUHAREKË

Për Aktivitetin e Prokurimit:

Numri I prokurimit: 624-26-4933-5-2-1

Numri i brendshëm: 624-26-39-521

Sa i përket tenderit për Titulli: **Ndertimi dhe rikonstruimi i memorialeve ne Leshan, Terrnje, Stravuin, Reshtan dhe Suharekë**

1. Identifikimi i OPERATORIT EKONOMIK

Milazim S. Shala B.I.

77, Shtjefën Gjegovi, Prizren,

(Kodi postar) 20020

044176579

(Numri Telefonit)

Milazim Shala

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)


Prizren,

(Adresa elektronike)

07.08.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)



2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i kërkesës mund ta parashtroj kërkesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse kërkesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimt të kërkesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

B05 Njoftim per Kontrat 23.06.2026

B12 Proces verbali i hapjes se Tenderve 13.07.26

B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues 23.07.2026

--Vendimi të kërkesës për rishqyrtim dt. 31.07.2026

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po



Jo



Hapja 13.07.2026

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

☒

Jo

☐

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

☒

Jo

☐

Bashkangjitur keni Kërkesat për rishqyrtim te vendimit te AK

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Ligji nr 04/L-042, i amandamentuar.

- Neni 1 i LPP-së – Qëllimi;
- Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi;
- Neni 56 Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave;
- Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve;
- Neni 60 Kriteret për Dhënien e Kontratës;
- Udhëzues 002 2024 për plotësim ndryshim të Udhëzuesit 001 2023 për prokurimin Publik

Neni 1 i LPP-së – Qëllimi

Vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues ka rënë in-komplet në kundërshtim me dispozitat e nenit 1 të LPP-së, duke dështuar të respektojë procedurat ligjore. Konkretisht, jemi eliminuar padrejtësisht nga procesi, pavarësisht faktit se kemi përmbushur plotësisht kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT), dhe nuk janë zbatuar parimet dhe procedurat e parapara për arritjen e qëllimit të LPP-s.



Neni 7 i LPP-së - Barazia në Trajtim / Jo-diskriminimi

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka kryer shkelje esenciale të dispozitave të nenit 7 të LPP-së, duke shkelur parimin e barazisë në trajtim dhe mosdiskriminimit. Konkretisht, është rekomanduar për kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë se oferta jonë, pavarësisht faktit se ne kemi përmbushur të gjitha kriteret e përcaktuara në Dosjen e Tenderit (DT). Për më tepër, jemi diskriminuar përmes eliminimit të pajustificuar, duke mos u zbatuar rregullat dhe procedurat ligjore të parapara me LPP rregullore dhe udhezues te prokurimit publik

Neni 56 - Dispozitat e Përgjithshme mbi Përzgjedhjen e Pjesëmarrësve dhe Dhënien e Kontratave

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 56 të LPP-së, duke dështuar të kryejë një vlerësim konform kërkesave dhe kriterëve të përcaktuara në Dosjen e Tenderit. Vlerësimi i ofertave nuk është bërë në përputhje të plotë me rregullat e përgjithshme për përzgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratës.

Neni 59 i LPP-së - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahësimi i Tenderëve

Pretendojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e nenit 59 të LPP-së, pasi ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve është kryer në mënyrë të njëanshme.

Ndonëse Autoriteti Kontraktues ka të drejtë të kërkojë me shkrim sqarime nga tenderuesit për aspektet e tenderit të tyre gjatë procesit të vlerësimit, ligji përcakton qartë se asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt thelbësor i tenderit nuk duhet të kërkojë apo pranohet nga autoriteti, e as të ofrohet nga tenderuesi. Në rastin tonë, ky parim nuk është respektuar si duhet gjatë trajtimit të ofertave.

Neni 60 i LPP-së - Kriteret për Dhënien e Kontratës

Vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues ka rënë në kundërshtim të hapur me dispozitat e nenit 60, paragrafi 1.1 të LPP-së, duke mos respektuar rregullat dhe procedurat ligjore për dhënien e kontratës. Konkretisht, është rekomanduar për kontratë një operator ekonomik me çmim më të lartë se oferta jonë, gjë që përbën shkelje direkte të kriterëve të përcaktuara nga vetë Autoriteti Kontraktues në Dosjen e Tenderit (DT) dhe njëkohësisht dëmton buxhetin e komunës.

Udhëzuesi Nr. 002/2024 për Plotësim-Ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik – Shkelja e Pikës 10 (Moskërkimi i Sqarimeve)

-Vlerësojmë se Autoriteti Kontraktues ka shkelur rëndë dispozitat e Udhëzuesit Nr. 002/2024 për plotësim-ndryshimin e Udhëzuesit Nr. 001/2023 për Prokurim Publik, konkretisht Pikën 10 që ka të bëjë me obligimin për kërkimin e sqarimeve.

Në kundërshtim të plotë me këtë udhëzues dhe parimet e prokurimit publik, Autoriteti Kontraktues ka dështuar të kërkojë sqarime shtesë për elementet e ofertës sonë përpara se të merrte vendim për eliminim, duke anashkaluar procedurat e detyrueshme që kërkojnë trajtim të drejtë dhe mundësi për sqarimin e paqartësive formale apo teknike.



7. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të kërkesës suaj për rishqyrtim.

Me datën 23.07.2026, Autoriteti Kontraktues – Komuna Suharekë, ka publikuar njoftimin mbi vendimin e AK— **B58 Njoftim mbi vendimin e autoriteti kontraktues**, Andaj bazuar ne nenin 108/A, të LPP-së, paraqesim këtë:

ANKESË

Duke u bazuar në të gjitha shkeljet e cekura më lart të neneve përkatëse të LPP-së, konstatojmë se Autoriteti Kontraktues ka vepruar në kundërshtim të plotë me dispozitat ligjore duke rekomanduar për kontratë një Grup të Operatorëve Ekonomikë (GOE) të papërgjegjshëm, i cili nuk plotëson kërkesat e përcaktuara në Dosjen e Tenderit.

Veprimet e deritanishme të Autoritetit Kontraktues paraqesin moszbatim flagrant të Ligjit për Prokurimin Publik (LPP), Rregullores së Prokurimit Publik, si dhe Udhëzuesve përkatës, duke shkelur parimet e konkurrencës së lirë, transparencës dhe barazisë. Kjo është bërë pavarësisht faktit se ne kemi ofruar **çmimin më të ulët** dhe kemi përmbushur në tërësi të gjitha kriteret dhe kërkesat e parapara në Dosjen e Tenderit.

Pretendimi nr 1

- Ne kemi dorëzuar pranë Autoritetit Kontraktues dëshmi të mjaftueshme dhe të plota që konfirmojnë përgjegjshmërinë tonë. Në rast se komisioni vlerësues ka pasur paqartësi, dilema apo dyshime deshmit e e ofruara, ai kishte detyrimin ligjor që të vepronte konform dispozitave të LPP-së, konkretisht Nenit 59 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve), si dhe dispozitave të Rregullores së Prokurimit Publik (RRPP), përkatësisht Nenit 38 (Sqarimi i Tenderëve) dhe Nenit 40 (Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahاسimi i Tenderëve), sidomos pikës 40.8, krahas Udhëzuesve përkatës të prokurimit public pika 10.
- Lëshimi i këtij hapi të detyrueshëm ligjor dhe eliminimi ynë pa kërkuar më parë sqarimet e nevojshme përbën shkelje procedurale dhe diskriminim të hapur.

Neni 8.5 i Udhëzuesit Nr. 002/2024 për Prokurim Publik, përkatësisht forma tabelore, përcakton kriteret e përzgjedhjes që mund të përdoren nga Autoriteti Kontraktues (AK) si kërkesa kualifikuese. Në asnjë rrethanë nuk kërkohet që CV-të të jenë të vete-nënshkruara; e rëndësishme mbetet kualifikimi i stafit, përvoja dhe provat e tjera që dëshmojnë këto kushte. Për më tepër, hartimi i CV-së mund t'i delegohet ligjërisht një palë të tretë ose të përgatitet nga vetë administrata e kompanisë.

Gjithashtu, Neni 10 i të njëjtit udhëzues përcakton qartë situatat në të cilat AK-ja është e obliguar të kërkojë sqarime shtesë, në përputhje me Nenet 72 dhe 59 të Ligjit për Prokurim Publik (LPP). Kjo vlen edhe për rastet kur CV-ja e stafit nuk dorëzohet fare, ku AK-ja detyrimisht duhet të kërkojë informata sqaruese.

Tabela Përmbledhëse e Veprimeve sipas LPP-së



Situata e Problemit	Veprimi i Obliguar i AK-së	Baza Ligjore (LPP / Udhëzues)
CV-ja e kërkuar nuk është dorëzuar	Mund / duhet të kërkohej informatë sqaruese	Neni 69 / Neni 10 i Udhëzuesit
CV-ja e dorëzuar është e paplotë (mungojnë informata) dhe AK nuk mund të vendosë	Mund / duhet të kërkohej informatë sqaruese	Neni 69 / Neni 10 i Udhëzuesit

Zbatimi në Rastin Konkret

Në rastin tonë specifik, bëhet fjalë pikërisht për situatën ku CV-ja e dorëzuar nuk përmban të gjitha informatat e kërkuara dhe AK-ja nuk mund të marrë një vendim përfundimtar pa kërkuar paraprakisht informata sqaruese, ashtu siç e përcakton rregullorja.

Kompania jonë ka dëshmuar plotësisht kapacitetin e saj përmes:

-Marveshjes së nënshkruar me Inxhinierine elektors

-Kopjeve të diplomave

-cv dhe referencat

Prandaj, veprimi i AK-së për të refuzuar ofertën pa kërkuar më parë sqarimet e nevojshme ligjore është në kundërshtim me dispozitat e zbatueshme të prokurimit publik.

Për më tepër, lidhur pikërisht me këtë çështje, **Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP)**, përmes vendimeve të tij dhe ekspertët shqyrtues përmes raporteve, në raste të ngjashme (situata identike) – siç është mosnënshkrimi i CV-së – e kanë trajtuar këtë si çështje ku Autoritetet Kontraktuese (AK) kanë pasur detyrim ligjor të kërkojnë sqarime dhe të vërtetojnë kualifikimet profesionale dhe përvojën e punës përmes referencave përkatëse.

PROVË: Si raste të ngjashme mund të konsiderohen edhe si **RES JURIDICA** raportet e ekspertizës së ekspertëve të OSHP-së me nr. 672/22 dhe 2023/0352 si dhe Vendimi i Panelit Shqyrtues për keto land (për raste të ngjashme).

Ne kemi ofruar dëshmi të plota dhe të pakundërshtueshme në Dosjen e Tenderit – duke bashkëngjitur **Marrëveshjen për bashkëpunim me inxhinierin e elektroteknikës**, diplomën përkatëse, dokumentet e tjera mbështetëse, si dhe duke dëshmuar përvojën përmes CV-së përkatëse – Autoriteti Kontraktues nuk i ka marrë parasysh këto dokumente vendimtare. Veprimi i tillë përbën shkelje të drejtpërdrejtë të dispozitave të LPP-së dhe Rregullores së Prokurimit Publik (RRPP), duke anashkaluar dokumentacionin valid të dorëzuar ju është dashur të veproni sipas lpp, rregullores dhe udhëzuesit në rast se keni pas paqartesi, apo të kerkoni dokumente shtese ne rast se keni pase paqartesi ne lidhje me dokumentet e ofruara.

Rrjedhimisht Komisioni i Vlerësimit dhe Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit kanë bërë lëshime dhe shkelje të rënda gjatë procesit të vlerësimit, duke rekomanduar për kontratë një Grup të Operatorëve Ekonomikë (GOE) të papërgjegjshëm. Edhe pas kërkeses sonë për rishqyrtim, AK në vendimin e kërkeses për rishqyrtim nuk i ka trajtuar fare keto shkelje.

Këto shkelje argumentohen si vijon:



Pretendimi nr 2

1. Mospërputhjet në dokumentacionin e stafit profesional (Inxhinierit të Ndërtimtarisë):
Kontrata e paraqitur për inxhinierin e ndërtimtarisë figuron me afat të pacaktuar si punë e rregullt nga viti 2022. Megjithatë, në CV-në e prezantuar nuk figuron fare se ai është i punësuar në kompaninë "Eko-Term" Sh.P.K. Kjo përbën një mospërputhje të papranueshme, e cila e bën operatorin ekonomik të papërgjegjshëm në këtë kërkesë.
Kërkojm nga OSHP ta vërtetoj këtë mos përputhje

Pretendimi nr 3

2. Mungesa e veprimtarisë adekuate të Operatorit Ekonomik "Iliria Mermer" Sh.P.K.:

Sipas kërkesave të Dosjes së Tenderit, ky operator ekonomik nuk mund të konsiderohet i përgjegjshëm. Në certifikatën e biznesit të tij nuk figurojnë aktivitetet për kryerjen e punëve që janë objekt i kontratës, duke e bërë atë ligjërisht të papërgjegjshëm për këtë aktivitet prokurimi.

Duke pasur parasysh të gjitha arsyet ligjore që u përmendën më lartë, kërkojmë nga OSHP-PANELI SHQYRTUES që të nxerrni:

V E N D I M

- **Te aprovet ne tërësi ANKESA si e bazuar**
- **ANULOHEM**, njoftimi mbi vendimin e AK-së (B58) për aktivitetin të prokurimit
- **Te kthehet lënda në ri vlerësim dhe të rekomandohet për kontratë operatori ekonomik Milazim S. Shala B.I.**
- Të lejohet kthimi i mjeteve të depunuar për Ankesë,
- Të merren masa ndaj zyrtarëve nëse konsiderohet shkele e rëndë të LPP-së.

8. Dëmet materiale

Përshtetja mënyrën se si shkelja e supozuar ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale, në rast se përfshini pretendime për kompensim.

Milazim S. Shala B.I. Në mbrojtje të interesave tona ekonomike dhe ligjore, në rast të vazhdiminës së veprimeve të kundërligjore, do të ndërmarrim të gjitha hapat e lejuar ligjorë dhe do të kërkojmë kompensimin e plotë të dëmeve, përfshirë edhe fitimin e humbur, pranë organeve kompetente.

9. Lista e dokumenteve (dëshmi) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni kërkesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
- b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
- c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës së tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
- d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet.

